



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

THIRRJE PUBLIKE

Komuna e Podujevës, përkatësisht Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport në Podujevë, ju bënë thirrje publike për aplikim të gjitha klubeve, shoqatave sportive që janë të regjistruara në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Podujevës, që janë dëshmuar në zhvillimin dhe masovizimin e sportit ndër të rinjët dhe, zhvillojnë aktivitetet dhe garat sipas programit të tyre për edicionin vjeshtor në vitin kalendarik 2018 .

Kërkesa duhet të përmbajë:

1. Qëllimin e kërkesës/projektit,
2. Përshkrimin e aktiviteteve të projektit/plan programit të vitit kalendarik 2018 me koston e tyre,
3. Kosto që kërkohet nga Komuna,
4. Rezultatet e arritura në vitin paraprak.
5. Raportin financiar për sezonin pranverorë.

Kërkesës duhet ti bashkëngjiten edhe këto dokumente:

1. Të jenë të regjistruara në DKRS
2. Çertifikata e OJQ-së
3. Çertifikata e numrit fiskal të klubit, shoqatës
4. Letërnjoftimi i bartësit të gjillogarisë
5. Vërtetimi / dëshmia e bankës në emër të subjektit i cili aplikon (Klubi, shoqata)
6. Të dhënat e aplikuesit: Telefoni, email adresa .

- ✓ Formulari i projekt/propozim
- ✓ Formulari i propozim buxhetit
- ✓ Formulari i deklaratës së partneritetit
- ✓ Formulari i deklaratës mbi financim të dyfishtë

Vlera totale e planifikuar e thirrjes është **7.000 €**

Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet për çdo klub ose shoqatë (OJQ) është **200 €**, ndërsa shuma maksimale është **2.000 €**.

Afati i fundit për aplikim është **15 ditë pune**, nga data e **02.10.2018** deri më **19.10.2018** .

Dokumentet e kompletuara dërgohen në zyrën nr.14 në komunën e Podujevës në zarfe të mbyllura.

Formularët mund të merret në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport dhe mund të shkarkohen online në faqen e Komunës së Podujevës.

<https://kk.rks-gov.net/podujeve/>

Vetëm projektet që janë në përputhshmëri me kriteret për aplikim të cekura më lartë, do të procedohen për shqyrtim nga komisioni i përzgjedhur .

Vërejtje:

Nuk do të merren në shqyrtim:

- 1. Klubet/shoqatat të cilat nuk janë përgjegjur kërkeses së DKRS-së për plotësimin e formularit të sportit Komunal 2018 .**
- 2. Konkuruesit të cilët nuk e kanë dokumentacionin e kompletuar .**

Podujevë
02.10.2018



Drejtor

Donika Sfishta

Donika Sfishta